



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL
GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Në mbështetje të nenit 12 pika c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 38 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr. 16-126211 datë 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 22 nënparagrafi 1.1 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve 01. nr. 016-126422 të datës 29.12.2016, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2017, merr

V E N D I M
P Ë R
NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIMIN E
AKTIVITETEVE TË KLUBIT FUTBOLLISTIK "DRITA" NË GJILAN

1. Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në shumën prej **40,000.00€** (dyzetmijë euro) për subvencionimin e aktiviteteve të klubit të futbollit "Drita" në Gjilan për vitin 2017.
2. Klubi është i obliguar të paraqes projekt propozimin në të cilin duhet të përshkruhen aktivitetet me agjendë të planifikuar dhe specifikuar në mënyrë financiare.
3. Klubi është i obliguar që të bëjë përmbylljen e mjeteve të shpenzuara dhe për këtë të paraqes raportin narrativ dhe financiar me dëshmi në afatin e përcaktuar me rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
4. Mjetet financiare ndahen nga buxheti i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01. nr. 016-64746
Gjilan, më 29.06.2017

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi